



VENDIMI DHE GJETJET

Data e miratimit: 29 qershor 2021

Lënda nr. 2016-22

Radmila Šapić

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur më 29 qershor 2021, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Anna AUTIO, kryesuese
Z. Petko PETKOV, anëtar

Ndihmuar nga:
Z. Ronald Hooghiemstra, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit më 11 dhjetor 2019.

Pas shqyrtimit përmes mjeteve elektronike, në përputhje me Rregulloren 13(3) të Rregullores së Punës së Panelit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURA PARA PANELIT

1. Ankesa në lidhje me këtë rast është regjistruar më 30 qershor 2016.
2. Përmes letrës së datës 1 korrik 2016, Paneli e informoi EULEX-in Kosovë ("Misioni") se ky rast është regjistruar në Panel.
3. Më 28 qershor 2017, Paneli kërkoi nga ankuesja informata shtesë.
4. Më 20 shtator 2017 dhe 17 tetor 2017, Paneli dërgoi edhe dy kërkesa të tjera për informata shtesë përmes përfaqësuesit për familjet serbe nga Qendra Burimore për Personat e Zhdukur, një OJQ me seli në Prishtinë. Ankuesja nuk ka dorëzuar asnjë informatë shtesë.

5. Më 8 dhjetor 2017, Paneli dërgoi një deklaratë të fakteve dhe pyetjeve tek shefja e atëherëshme e Misionit dhe e ftoi atë për të dhënë përgjigje dhe vërejtje me shkrim ndaj ankesave më së voni deri më 26 janar 2018.
6. Misioni, përmes një letre të datës 4 janar 2019, kërkoi sqarime rreth disa pikëve në lidhje me formën e ankesës dhe lidhjen mes ankueses dhe personave të përmendur në ankesë.
7. Përmes një letre të datës 17 janar 2019, Misionit prapë iu kërkua që të jepte përgjigje ndaj pyetjeve deri më 16 shkurt 2019.
8. Përmes një letre të datës 31 janar 2019, Paneli i kërkoi ankueses që të rregullonte çështjet në lidhje me formën e ankesës dhe të sqaronte lidhjen e saj me personat e përmendur në ankesë. Ankuesja u përgjigj më 7 shkurt 2019.
9. Përmes një letre të datës 8 prill 2019, Misionit edhe njëherë iu kërkua që të jepte përgjigje ndaj pyetjeve dhe vërejtjeve me shkrim sa më parë që ishte e mundur.
10. Më 20 qershor 2019, ankuesja u informua se Paneli ende ishte në proces të shqyrtimit të ankesës së saj.
11. Vërejtjet e Misionit mbërritën të datës 17 prill 2020, u morën më 21 prill 2020 dhe u përcollën më tutje nga Paneli tek ankuesja më 8 korrik 2020.
12. Më 28 korrik 2020, në Panel mbërritën komentet e ankueses rreth vërejtjeve të Misionit.
13. Më 7 gusht 2020, Paneli i përcolli komentet e ankueses tek Misioni.
14. Më 11 dhjetor 2020, Paneli lëshoi vendimin e tij mbi pranueshmërinë, duke e shpallur ankesën të pranueshme në lidhje me nenet 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ("Konventa") dhe neneve 9 dhe 11 të Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore ([2020-12-11-Admissibility-Decision-2016-22.pdf](https://www.european-courts.org/european-court-of-human-rights/decisions/2020-12-11-Admissibility-Decision-2016-22.pdf) ([hrrp.eu](https://www.hrrp.eu)). Në atë vendim, Paneli u ka kërkuar palëve që t'i trajtojnë pyetjet e mëposhtme:

- **Ankuesja:**

- i. Ju lutemi të shpjegoni mbështetjen apo ndihmën apo banimin që prindërit tuaj kanë siguruar për juve dhe familjen tuaj para zhdukjes së tyre.
- ii. Ju lutemi të shpjegoni ndikimet personale dhe emocionale që zhdukja e prindërve tuaj ka pasur mbi juve dhe familjen tuaj.
- iii. Ju lutemi të shpjegoni ndikimet juridike dhe financiare që zhdukja e prindërve tuaj ka pasur mbi juve dhe familjen tuaj. Po ashtu shpjegoni ndonjë pengesë apo vështirësi që mund të jeni përjetuar si rezultat i asaj që prindërit tuaj vazhdojnë të jenë të zhdukur, gjatë kërkimit të qasjes në ndonjë mbështetje, pagesë apo titull juridik, si ato të cekura në pyetjet më poshtë. Për shembull:
 - a. A keni pasur qasje të plotë, të pjesshme apo fare në ndonjë përfitim, pagë, pension, asistencë sociale dhe llogari bankare që prindërit tuaj i kanë gëzuar apo do t'i kishin gëzuar?
 - b. A keni trashëguar titullin juridik në ndonjë pronë, përfshirë banim, që prindërit tuaj mund të kenë pasur?
 - c. A keni pasur shpenzime financiare si rezultat i zhdukjes së prindërve tuaj që nuk janë kompensuar?

- **Misioni:**

- i. Çfarë parashtrime dëshiron të bëjë Misioni në lidhje me substancën e të drejtave të njeriut të cekura më lart?
- ii. Çfarë hapa, nëse është ndërmarrë ndonjë, janë ndërmarrë nga Misioni drejt autoriteteve të vendit në lidhje me këtë rast? Në veçanti, a i ka pyetur Misioni autoritetet e vendit nëse (a) ato kanë qenë në dijeni për ekzistimin e rasti dhe (b) nëse ato janë duke e hetuar atë, dhe nëse jo, (c) përse.
- iii. Çfarë roli, nëse ka ndonjë, ka për qëllim të ketë Misioni në të ardhshme në lidhje me këtë rast të pazgjidhur të zhdukjes së detyruar? Çfarë mase apo veprim konkret e konsideron Misioni në kuadër të kompetencave të tij (aktuale) për të kërkuar avancimin e hetimeve dhe zgjedhjen e këtij rasti? Nëse Misioni nuk ka për qëllim të ndërmerr ndonjë hap në lidhje me këtë rast, përse ashtu?
- iv. A i janë dërguar dokumentet rreth këtij rasti autoriteteve kosovare pas ndryshimit të mandatit të Misionit në qershor 2018 dhe pas zvogëlimit të kompetencës ekzekutive?
- v. A ka bërë përpjekje Misioni që t'i identifikojë familjarët, përfshirë fëmijët e gjallë, të personave të zhdukur në rastin aktual, përveç familjarëve të identifikuar në parashtrimet e Misionit dhe dokumentet konfidenciale të ndërlidhura? Nëse jo, përse?
- vi. A ka bërë përpjekje Misioni që të kontaktojë ankuesen apo familjarët e prindërve të zhdukur të ankueses përtej hapave të përmendur në parashtrimin e Misionit dhe dokumenteve konfidenciale të ndërlidhura? Nëse jo, përse?

15. Palëve iu kërkuar të ofronin parashtrimet e tyre më së largu deri më 28 shkurt 2021.

16. Më 11 dhjetor 2020, ShM dorëzoi vërejtje shtesë mbi meritat si pjesë e vërejtjeve të Misionit mbi meritat që kanë të bëjnë me disa raste në lidhje me personat e zhdukur, duke përfshirë edhe këtë këtu. Misioni paraqiti këto vërejtje në përgjigje të një letre nga Paneli dërguar më 18 shtator 2020 duke thënë se Paneli do të fillojë të vendosë për pranueshmërinë dhe meritat në një vendim të vetëm në vitin e ri (d.m.th. 2021), për të shpejtuar procedurat në rastet e personave të zhdukur. Në rastin aktual, Paneli vendosi së pari dhe veçmas për pranueshmërinë dhe Misioni ende nuk e kishte vendimin e Panelit për pranueshmërinë të datës 11 dhjetor 2020 kur i dha këto vërejtje.

17. Më 17 dhjetor 2020, Paneli ia përcolli vërejtjet e Misionit mbi meritat ankueses, e cila ishte ftuar të paraqesë komentet e saj mbi meritat e lëndës, nëse ka, para datës 31 janar 2021.

18. Më 30 janar 2021, ankuesja paraqiti komentet e saj në përgjigje të vërejtjeve të Misionit mbi meritat e lëndës.

19. Më 19 prill 2021, Paneli pranoi parashtrirat e Misionit në përputhje me pyetjet në vendimin e pranueshmërisë. Këto i dërgoheshin ankueses për informacionin e saj, gjithashtu më 19 prill 2021.

20. Asnjë parashtrirë tjetër nuk u mor nga ankuesi.

II. PËRBËRJA E PANELIT

21. Pas dorëheqjes së një prej anëtarëve të tij të përhershëm dhe dorëheqjes së anëtarit të Tij, i cili ishte një anëtar i stafit të Shtyllës së Monitorimit të Misionit, Paneli do të shqyrtojë Këtë lëndë me vetëm dy anëtarë, në përputhje me rregullat 11 dhe 14 të rregullores së punës së Panelit.

III. FAKTET

22. Më 18 maj 1998 apo rreth kësaj date, shumë banorë të fshatit Leçinë u larguan nga fshati për arsye sigurie. Prindërit e ankueses, banorë të fshatit, qëndruan në shtëpinë e tyre.
23. Më 18 maj 1998 apo rreth kësaj date, një grup i armatosur hyri në fshat dhe nëpër shtëpitë e familjeve, përfshirë edhe në shtëpinë e prindërve të ankueses, sipas një dëshmitari. Ky dëshmitar, kushëri i ankueses, kishte arritur të ikte në një mal në afërsi. Dëshmitari kishte dëgjuar britma dhe të shtëna që vinin nga shtëpia dhe kishte parë se si grupi i armatosur i kishte djegur shtëpitë e familjes.
24. Nuk ka pasur asnjë gjurmë të prindërve të ankueses.
25. Edhe tre të afërm të tjerë më të largët të ankueses po ashtu ishin zhdukur po më atë datë apo rreth asaj date. Ata persona ishin halla e ankueses dhe djali i saj, të dy të pranishëm në fshat në kohën e ngjarjes, si dhe një kushërirë tjetër e ankueses, e cila për herë të fundit ishte parë në një pikë-kontrolli të policisë serbe gjatë rrugës së saj për në fshat. Nuk ka pasur asnjë gjurmë të asnjë prej këtyre tre personave.
26. Zhdukjet ishin raportuar tek Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (ICRC), Kryqi i Kuq i Jugosllavisë dhe tek Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara (UNMIK). ICRC-ja dhe Kryqi i Kuq i Jugosllavisë hapën kërkesat për gjurmimin e prindërve të ankueses më 20 maj 1998 dhe përkatësisht 24 qershor 1998.
27. Gjatë periudhës 2001-2002, ICRC dhe Shoqata e familjarëve të personave të zhdukur morën të dhëna ante-mortem nga disa familjarë për të lehtësuar gjurmimin.

IV. PARASHTRIMET E PALËVE RRETH MERITAVE

Ankuesja

28. Ankuesja pretendon se Misioni, gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv, është dashur ta hetonte zhdukjen e prindërve të saj dhe me faj nuk ka vepruar ashtu, duke u shkelur kështu të drejtat e saj të njeriut.

Shefi i Misionit - parashtrimet e datës 17 prill 2020

29. Paneli thekson që Misioni kishte ofruar disa parashtrësra mbi meritat në parashtrësat e tij të mëparshme, të datës 17 prill 2020, dhe të cilat, pjesërisht, janë përshkruar në Vendimin mbi Pranueshmërinë (paragrafët 27 deri 38) dhe të rëndësishme për këtë vendim gjithashtu.
30. Në ato parashtrësra, Misioni shpjegoi, *ndër të tjera*, se efekti i kombinuar i një numri të madh të lëndëve dhe burimesh të kufizuara bëri që Misioni t'i jepte përparësi 1,200 dosjeve të lëndëve të etiketuara 'krime lufte' nga UNMIK-u - ndaj 'dosjeve të personave

të zhdukur' – dhe brenda kategorisë së mëparshme, rastet që shfaqeshin 'më premtuese për sa i përket rezultateve të hetimit'.

31. Misioni deklaroi se “nuk e konteston që ankuesja, si një viktimë indirekte e shkeljeve të pretenduara, ka të drejtë për një hetim efektiv për zhdukjen e prindërve të saj. Megjithatë, ai pohon se njësitë e tij përkatëse ndërmorën të gjitha hapat e arsyeshëm për të hetuar lëndën dhe nuk shkelën të drejtat e ankueses”.
32. Misioni iu referua detyrimit procedural sipas nenit 2 të Konventës duke qenë ‘një nga mjetet dhe jo nga rezultati’; ajo që është e rëndësishme është që autoritetet kanë bërë gjithçka që mund të pritej arsyeshëm prej tyre në rrethanat e lëndës “(i referohet lëndës të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut të *Trivkanovic*, paragrafi 78; *Borojevic*, par. 57 dhe *Njezic*, par. 69).
33. Misioni më tej deklaroi si vijon:

“[...] Në kohën e dorëzimit nga UNMIK-u, hetimi penal nga NjQHP e UNMIK-ut [Njësia Qendrore e Hetimit Penal] u konsiderua e mbyllur. EULEX-i nuk e arkivoi rastin; përkundrazi, Prokurori i saj kërkoi nga NjHKL [Njësia për Hetimin e Krimeve të Luftës në EULEX] të ndërmarrë hapa hetues. NjHKL-ja nuk mund të ndiqte kërkesën e prokurorisë gjatë viteve të para të mandatit të EULEX-it, për shkak të numrit të lartë të kërkesave të ngjashme që vinin nga PSRK [Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës] (afro 900 [...]). Sidoqoftë, ai ndërmori hapa hetues në 2013, kur një letër e re u lëshua nga një prokuror tjetër. Për fat të keq, këto hapa nuk çuan në zbulimin e ndonjë drejtimi të dobishëm për të çuar përpara hetimin dhe për këtë arsye lënda u pushua përfundimisht. Siç u përmend më lart, pushimi nuk përjashton mundësinë e paraqitjes së një kallëzimi të ri penal në qoftë se informacioni i ri del në dritë”.

34. Në fund, Misioni deklaroi se pasi që nuk kishte prova në lëndën këtu, hedhja poshtë e kallëzimit penal nuk ishte vetëm një hap i arsyeshëm por edhe një proporcional duke marrë parasysh numrin e madh të lëndëve dhe pengesat themelore me të cilat ballafaqohej Misioni.

Shefi i Misionit – parashtrimet e datës 11 dhjetor 2020

35. Me një letër të 11 dhjetorit 2020, shefi i Misionit tregoi se nuk kishte ‘nevojë’ për parashtrime shitesë mbi meritat e kësaj lënde dhe parashtroi që ‘Misioni nuk beson se të drejtat e ankuesit ishin shkelur’.
36. Misioni bëri disa parashtrime të përgjithshme, duke u bërë jehonë atyre në parashtrimet e tij të datës 17 prill 2020, në lidhje me disa nga sfidat praktike që lidhen me hetimin e këtyre llojeve të lëndëve dhe pranoi se ishte përballur me sfida në menaxhimin e dosjeve të marra nga UNMIK-u.

Parashtresat e ankuesit në përgjigjen e dhënë

37. Më 17 dhjetor 2020, parashtresat e Misionit për meritat e lëndës iu përcollën ankuesit.
38. Me një letër të datës 30 janar 2021, ankuesi dha komente mbi parashtresat e Misionit, veçanërisht duke mos qenë dakord me përfundimin nga shefi i Misionit se të drejtat e ankuesit nuk ishin shkelur.

39. Ankuesja në komentet e saj deklaroi se Misioni kishte një detyrim të hetonte të gjitha rastet e personave të zhdukur dhe të mos t'i jepte lëndëve të caktuara, të tilla si zhdukja e prindërve të saj dhe anëtarëve të tjerë të familjes, përparësi më të vogël. Ankuesi gjithashtu iu referua kalimit të konsiderueshëm të kohës që nga faktet, dhe gjasës që ulej që, 22 vjet pas fakteve, lëndët të mund të zgjidheshin. Ankuesi u duk se pohoi se Misioni e ka vonuar qëllimisht hetimin e kësaj dhe rasteve të tjera në një pikë ku autorët nuk mund të gjenden më.
40. Ankuesi më tej kërkoi nga Misioni të "shqyrtojë akuzat penale të refuzuara në këtë rast, sepse sipas mendimit të ankuesit, jo të gjitha veprimet hetimore janë shteruar, që mund të çojë në ndjekjen penale të atyre që janë përgjegjës për zhdukjen, rrëmbimin dhe vrasjen e prindërve të [ankueses] [...]".

Shefi i Misionit – parashtresat e datës 19 prill 2021

41. Në parashtresat e tij në përputhje me pyetjet e Panelit në Vendimin mbi Pranueshmërinë, Misioni iu referua parashtresave të tij të mëparshme në të cilat Misioni deklaroi se për mendimin e tij, nuk kishte shkelje të të drejtave të ankuesit.
42. Në lidhje me ftesën e Panelit, në Vendimin e tij mbi Pranueshmërinë, ndaj Misionit për të mos përsëritur parashtresat që Paneli tashmë i ka refuzuar në rastet e mëparshme, Misioni deklaroi se nuk mund të pajtohet me ftesën, pasi vërejtjet e tij mbi meritat në një lëndë janë "bazuar në një vlerësim të të gjitha fakteve relevante të vendosura pas një hulumtimi të plotë të të dhënave në dispozicion".
43. Misioni deklaroi se "pendohet që znj. Sapic nuk ishte informuar për hedhjen poshtë të kallëzimit penal në lidhje me zhdukjen e prindërve të saj dhe kërkon falje për këtë lëshim".
44. Misioni më tej deklaroi se ai "kategorikisht e hedh poshtë pretendimin" të bërë nga ankuesi se Misioni kishte vonuar qëllimisht lëndën dhe vëri në dukje se nuk kishte prova për të mbështetur pretendimin.
45. Në lidhje me një pretendim të bërë nga ankuesi se Misioni nuk kishte intervistuar dëshmitarin e vetëm të mbijetuar në rast, Misioni deklaroi se nuk mund ta kishte bërë këtë pasi dëshmitari ndërroi jetë para fillimit të mandatit të Misionit. Misioni gjithashtu iu referua hapave hetues që ai ndërmori në 2013, të përshkruara në paragrafin 32 të Vendimit të Panelit mbi Pranueshmërinë, duke nënvizuar mungesën e drejtimeve të dobishme si rezultat i hapave dhe hedhjes pasuese të kallëzimit penal.
46. Sa i përket kërkesës së ankuesit për Misionin për të shqyrtuar akuzat e refuzuara, Misioni deklaroi se nuk ka mandat për ta bërë këtë dhe sugjeroi që ankuesja duhet të komunikojë me 'autoritetet përkatëse' në rast se mendon se ka informacion që është e rëndësishme për hetimin.
47. Në lidhje me nenet 9 dhe 11 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Misioni vuri në dukje se ankuesi nuk kishte pretenduar shkelje të këtyre të drejtave dhe nuk u ishte përgjigjur pyetjeve të Panelit në Vendimin mbi Pranueshmërinë. Misioni më tej vuri në dukje se "EULEX-i është i vetëdijshëm se zhdukjet me forcë mund të ndikojnë në gëzimin e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore [...]. Sidoqoftë, këto konsiderata nuk kanë asnjë lidhje me sjelljen e mandatit ekzekutiv të EULEX-it. Në përputhje me Ligjin e Kosovës Nr. 04/L-023 për Personat e Zhdukur, si një e afërme e ngushtë e personave të zhdukur në lidhje me konfliktin në Kosovë, znj. Sapic ka të drejtë të ushtrojë një numër të drejtash dhe gëzimi i këtyre të drejtave nuk varen nga rezultati i secilit hetim penal".

48. Në pyetjen e Panelit mbi hapat e ndërmarrë nga Misioni drejt autoriteteve vendore në këtë rast, Misioni deklaroi se dosja e lëndës ishte dorëzuar në nëntor 2018, dhe se ankuesi mund të kërkojë qasje në të dhe të kërkojë që të dëgjohet nga autoritetet kompetente. Misioni më tej siguroi të dhënat përkatëse të kontaktit, të cilat i kaluan ankuseses kur Paneli ia përcolli asaj parashtrësat e Misionit në 19 prill 2021.
49. Për pyetjen mbi rolin, nëse ka ndonjë, që Misioni synon të luajë dhe çdo masë konkrete brenda mandatit të saj aktual që mund të marrë në lidhje me këtë rast, Misioni përsëriti se ai iu kishte kaluar dosjen e lëndës autoriteteve kompetente në nëntor 2018 dhe "ftoi PSRK-në të bëjë një vlerësim të ri të kësaj lënde si dhe të të gjitha rasteve të tjera që u hodhën poshtë gjatë mandatit të EULEX-it". Për më tepër, Misioni bëri një vërejtje të përgjithshme të mbështetjes së tij për institucionet e Kosovës, duke përfshirë rastet e personave të zhdukur.
50. Në lidhje me dorëzimin e dokumenteve të rastit tek autoritetet e Kosovës pas ndryshimit në mandatin e Misionit në qershor 2018, Misioni deklaroi se kishte dorëzuar të gjithë dosjen e lëndës në nëntor 2018.
51. Për sa i përket asaj nëse Misioni ishte përpjekur të identifikonte të afërmit, përfshirë fëmijët e gjallë, të personave të zhdukur në rastin në fjalë, përveç të afërmit të identifikuar në parashtrësat e mëparshme të Misionit dhe dokumenteve përkatëse konfidenciale, Misioni deklaroi se ai "nuk ka gjeti prova se u bënë përpjekje të tilla, por nuk mund ta përjashtojë atë".
52. Në pyetjen nëse Misioni u përpoq të kontaktojë ankuesin ose familjarët e prindërve të zhdukur të ankuesit përtej hapave të përshkruar në paraqitjen e Misionit dhe dokumenteve përkatëse konfidenciale, dhe nëse jo, pse jo, Misioni nuk ofroi ndonjë përgjigje të drejtpërdrejtë. Në vend të kësaj, Misioni deklaroi si vijon: "Në periudhën e ardhshme, Misioni do të kontaktojë ankuesen me qëllim që t'u përgjigjet pyetjeve që ajo mund të ketë".

Parashtrësat e ankuseses në lidhje me Vendimin mbi Pranueshmërinë

53. Paneli nuk ka marrë parashtrësata të tjera nga ankuesja dhe nuk ka marrë ndonjë përgjigje për pyetjet e Panelit në Vendimin e tij mbi Pranueshmërinë.

V. SHQYRTIMET

"Zhdukja me forcë" si një shkelje e rëndë e të drejtave themelore të një viktime

54. Praktika e zhdukjes me forcë është një nga shkeljet më të ashpra të të drejtave të njeriut. Zhdukjet me forcë shpesh përfshijnë shkeljen e një lloji të të drejtës por të shumë, duke përfshirë të drejtën për të vërtetën, të drejtën e njohjes si person para ligjit, të drejtën për liri dhe sigurinë e personit, të drejtën për të mos iu nënshtruar torturës dhe trajtim ose ndëshkim tjetër mizor, çnjerëzor ose poshtëruës, dhe të drejtën për një zgjidhje efektive. E rëndësishmja është se një sjellje e tillë gjithashtu shkel ose përbën një kërcënim të rëndë për të drejtën për jetë. Shih, p.sh., *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, Vendimi dhe Gjetjet, 19 tetor 2016, par. 33; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 61; Deklarata për Mbrojtjen e Të gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë, A/RES/47/133, 18 dhjetor 1992.

55. Veçanërisht e rëndësishme në rastet e zhdukjes me forcë është e drejta e ankuesit për të vërtetën, d.m.th., e drejta e viktimave të dinë se çfarë ndodhi me të afërmit e tyre të ngushtë dhe rrethanat në të cilat të afërmit e tyre u zhdukën. Shih, në përgjithësi, *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 62.
56. E drejta për të vërtetën në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut nuk është vetëm një e drejtë individuale. Gjithashtu është një e drejtë kolektive, që shërben për të ruajtur kujtesën në nivelin e shoqërisë dhe duke vepruar si një mbrojtje kundër përsëritjes së shkeljeve. Shih Komentin e Përgjithshëm mbi të Drejtën për të Vërtetën në lidhje me Zhdukjen me Forcë, Raportin e Grupit Punues për Zhdukjet e Detyruara ose të Vullnetshme (2010), Dokumenti A/HRC/16/48, Preambulë. Në kontekstin pas konfliktit të Kosovës, hetimet e zhdukjeve me forcë kanë kontribuar - dhe vazhdojnë të kontribuojnë - në promovimin e së vërtetës, në kujtesën kolektive të shkeljeve të tilla të të drejtave të njeriut dhe në sigurimin e mos-përsëritjes së tyre.
57. Në rastin në fjalë, ankuesja ka jetuar për më shumë se dy dekada me pasigurinë në lidhje me fatin e prindërve të saj, çfarë ndodhi me ta dhe në cilat rrethana u zhdukën. Vuajtjet psikologjike që vijnë nga kjo nuk janë thjesht të mëdha. Është në vazhdim. Shih *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 63.
58. Për shkak të natyrës së vazhdueshme të shkeljes së të drejtave të përfshira në zhdukjet me forcë, detyra e autoriteteve kompetente për të hetuar në mënyrë efektive këto raste është një obligim urgjent dhe i rëndësishëm që mund të lihet mënjanë ose të vonohet vetëm në rrethanat më të ngushta. Shih *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 64.

Detyrat dhe detyrimet e autoriteteve në lidhje me veprimet e zhdukjes me forcë

59. Veprimet e prokurorëve dhe policisë së Misionit ishin pjesë e mandatit të tij ekzekutiv, para ndryshimit të mandatit të Misionit në qershor 2018. Si të tilla, ato bien brenda fushës së mandatit të Panelit (shih, për shembull, *K deri në T kundër EULEX-it*, 2013-05 deri 2013-14, 21 prill 2015, paragrafi 43, *Krlić kundër EULEX-it*, 2012-21, 26 gusht 2014, paragrafi 23, *Y kundër EULEX-it*, 2011-28, 15 nëntor 2012, par. 35). Ky është rasti nëse sjellja themelore në fjalë konsiston në një veprim pozitiv ose një lëshim fajtor nga Misioni. (Shih *Krlić kundër EULEX-it*, 26 gusht 2014, par. 25; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 48).
60. Paneli tashmë ka pasur rastin të theksojë se Misioni nuk është shtet dhe se aftësia e tij për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut nuk mund të krahasohet në të gjitha aspektet përkatëse me atë që mund të pritët nga një shtet (shih, p.sh., Vendimi i Panelit në *A, B, C, D kundër EULEX-it*, 2012-09 deri 2012-12, 20 qershor 2013, par. 50; *K deri T kundër EULEX-it*, cituar më lart, paragrafi 53; shih gjithashtu Panelin Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të UNMIK (PKDNj) vendimi në lëndët nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, par. 35; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, paragrafi 49).
61. Pritjet e vëna mbi aftësinë e Misionit për të hetuar dhe zgjidhur raste komplekse penale duhet të jenë realiste dhe të mos vendosin mbi të një barrë joproporcionale që mandati dhe burimet e tij nuk mund të pritët të përbushen (shih *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, Vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015, paragrafët 43 dhe 45).
62. Në secilin rast, Paneli pritët të shqyrtojë nëse kishte pengesa konkrete dhe reale që mund të kishin minuar kapacitetin e Misionit për të kryer një hetim të shpejtë dhe efektiv për një lëndë. Një vlerësim i tillë nuk ka për qëllim të justifikojë mangësitë operationale që nuk

lidhen me sfida konkrete dhe të demonstrueshme. (shih *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, Vendimi dhe Gjetjet, 11 nëntor 2015, par. 44; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 50).

63. Në secilin rast, veçanërisht në raste të këtij niveli serioziteti, autoritetet hetimore pritet të veprojnë me kujdes dhe shpejtësi të arsyeshme dhe të investojnë burime në përpjesëtim me domosdoshmërinë dhe mundësinë e zgjidhjes së rastit. Ndërsa asnjë autoritet hetimor nuk mund të pritët të zgjidhë të gjitha lëndët e paraqitura para tij, ai pritët të veprojë me aq zell, shpejtësi dhe efektivitet sa reflekton peshën e çështjes nën hetim (shih *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, Vendimi dhe Gjetjet, 11 nëntor 2015, paragrafët 46 dhe 59, shih gjithashtu *Varnava dhe të tjerët k. Turqisë*, Aplikacioni nr. 16064/90 e tutje, aktgjykimi i 18 shtatorit 2009, par. 191; *Palić k. Bosnjë dhe Hercegovinës*, Aplikacioni nr. 4704/04, aktgjykimi i 15 shkurt 2011, par. 63; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 54).
64. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka përcaktuar një numër parimesh të përgjithshme mbi atë që kërkon ligji për të drejtat e njeriut dhe pret një hetim efektiv mbi pretendimet për shkelje të të drejtave sipas nenit 2 të Konventës Evropiane (*Mustafa Tunç dhe Fecire Tunç kundër Turqisë*, Aplikacioni nr. 24014/05, Aktgjykim, 14 prill 2015 (Dhoma e Madhe), paragrafët 169 e poshtë). Në veçanti, Gjykata deklaroi në *Mustafa Tunç dhe Fecire Tunç kundër Turqisë* si më poshtë:

172. Në mënyrë që të jetë 'efektiv' pasi kjo shprehje duhet të kuptohet në kontekstin e nenit 2 të Konventës, një hetim së pari duhet të jetë adekuat (shih *Ramsahai dhe të tjerët kundër Holandës* [GC], nr. 52391/99, § 324, GJEDNJ 2007 II). Kjo do të thotë, ai duhet të jetë i aftë të çojë në vërtetimin e fakteve dhe, kur është e përshtatshme, në identifikimin dhe dënimin e përgjegjësve.

173. Detyrimi për të kryer një hetim efektiv është një detyrim jo për rezultate, por për mjetin: autoritetet duhet të marrin masat e arsyeshme në dispozicion të tyre për të siguruar prova në lidhje me incidentin në fjalë [shih *Jaloud kundër Holandës* [GC], nr. 47708/08, § 186, KEDNj 2014; dhe *Nachova dhe të tjerët k. Bullgarisë* [GC], nr. 43577/98 dhe 43579/98, § 160, KEDNj 2005 VII).

174. Në çdo rast, autoritetet duhet të ndërmarrin çfarëdo hapi të arsyeshëm që mundën për të siguruar provat në lidhje me incidentin, duke përfshirë, ndër të tjera, dëshminë e dëshmitarit okular, provat mjeko-ligjore dhe, kur është e përshtatshme, një autopsi e cila siguron një regjistër të plotë dhe të saktë të dëmtimit dhe një analizë objektive e gjetjeve klinike, përfshirë edhe shkaku e vdekjes. Çdo mungesë në hetim që minon aftësinë e tij për të vërtetuar shkaku e vdekjes ose personi përgjegjës do të rrezikojë të mos përmbush këtë standard (shih *Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë* [GC], nr. 23458/02, § 301, KEDNj 2011).

175. Në veçanti, përfundimet e hetimit duhet të bazohen në një analizë të hollësishme, objektive dhe të paanshme të të gjithë elementëve të rëndësishëm. Mosrespektimi i një linje të qartë hetimi minon në një masë vendimtare aftësinë e hetimit për të përcaktuar rrethanat e çështjes dhe, kur është e përshtatshme, identitetin e atyre që janë përgjegjës (shih *Kolevi kundër Bullgarisë*, nr. 1108/02, § 201, 5 nëntor 2009).

176. Sidoqoftë, natyra dhe shkalla e shqyrtimit që plotësojnë pragun minimal të efektivitetit të hetimit varen nga rrethanat e lëndës së veçantë.

Nuk është e mundur të zvogëlohet shumëllojshmëria e situatave që mund të ndodhin në një listë të zhveshur të akteve të hetimit ose kritereve të tjera të thjeshtësuara (shih *Tanrikulu kundër Turqisë* [GC], nr. 23763/94, §§ 101-110, KEDNJ 1999-IV; dhe *Velikova kundër Bullgarisë*, nr. 41488/98, § 80, KEDNJ 2000 VI).

[...]

178. Një kërkesë për shpejtësi dhe ekspeditë e arsyeshme është e nënkuptuar në këtë kontekst (shih *Al-Skeini dhe të tjerët*, cituar më lart, § 167).

179. Për më tepër, hetimi duhet të jetë i arritshëm për familjen e viktimës në masën e nevojshme për të mbrojtur interesat e tyre legjitime. Duhet të ketë gjithashtu një element të mjaftueshëm të vëzhgimit publik të hetimit, shkalla e të cilit mund të ndryshojë nga rasti në rast (shih *Hugh Jordan k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 24746/94, § 109, KEDNJ 2001 III). Hyrja e nevojshme e publikut ose e të afërmeve të viktimës mund të parashikohet në faza të tjera të procedurës (shih, ndër autoritetet e tjera, *Giuliani dhe Gaggio*, cituar më lart, 4 304; dhe *McKerr kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 28883/95, § 129, KEDNJ 2001 III).

[...]

181. Çështja nëse një hetim ka qenë mjaft i efektshëm duhet të vlerësohet në bazë të të gjitha fakteve përkatëse dhe në lidhje me realitetet praktike të punës hetimore (shih *Dobriyeva dhe të tjerët kundër Rosisë*, nr. 18407/10, § 72, 19 dhjetor 2013; dhe *Qendra për Burime Ligjore në emër të Valentin Câmpeanu kundër Rumanisë* [GC], nr. 47848/08, § 147, 17 korrik 2014).

65. Lidhur me kërkesën e përshpejtimit, Paneli dëshiron të theksojë që Misionit i kërkohet të hetojë pretendimet e besueshme të shkeljeve të të drejtave të njeriut me zell dhe shpejtësi, dhe të sigurojë në të gjitha rastet që përgjigja hetimore e Misionit të jetë në përpjesëtim me peshën e lëndës. Si përmbledhje, përgjigja duhet të jetë e tillë që të garantojë mbrojtjen efektive të të drejtave në fjalë (shih, përgjithësisht, *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 56; *Sadiku-Syla kundër EULEX*, 2014-34, 19 tetor 2016, par. 36. Shih gjithashtu *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*, Kërkesa nr. 16064/90 et al, aktgjykim i 18 shtatorit 2009, par. 191.)
66. Një hetim rreth një zhdukje me forcë duhet të fillojë sa më shpejt që të jetë e mundur dhe të shmangen vonesat sa më shumë që të jetë e mundur. Kjo nuk është vetëm për shkak të efektit të pasigurisë mbi të afërmit e mbijetuar. Kjo është gjithashtu sepse provat do të zhduken ose do të humbasin, dhe kujtesa zbehet. Vonesat në hetime ka të ngjarë të ndikojnë negativisht në mundësinë e një hetimi që përcakton rrethanat në të cilat një person është zhdukur dhe për të sjellë fajtorët para drejtësisë. (Për ilustrimet e zbatimit të kësaj garancie në kontekste të ndryshme, shih në përgjithësi: *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 65; *Gürtekin dhe të tjerët kundër Qipros*, Vendimi i GJEDNJ-së për papranueshmëri të 11 mars 2014; *Al-Skeini dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], Aplikacioni nr. 55721/07, Aktgjykimi i GJEDNJ i 7 korrikut 2011; *Jaloud k. Holandës* [GC], Aplikacioni nr. 47708/08, Gjykimi i GJEDNJ i 20 nëntorit 2011; *Jelić kundër Kroacisë*, Aplikacioni nr. 57856/11, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 12 qershorit 2014; *B. dhe të tjerët kundër Kroacisë*, Aplikacioni nr. 71593/11, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 18 qershorit 2015; *Palić kundër Bosnjës dhe Hercegovina*, Aplikacioni nr. 4704/04, Aktgjykimi i GJEDNJ i 15 shkurt 2011; *Lejla Fazlić dhe të tjerët k. Bosnjë dhe Hercegovinë* dhe 4 të tjerë, Aplikacioni nr. 66758/09, 66762/09, 7965/10,

9149/10 dhe 12451/10, Aktgjykimi i GJEDNj-së i 3 qershorit 2014, *Mujkanović dhe të tjerët k. Bosnjë dhe Hercegovinë*, Aplikacioni nr. 47063/08 e tutje, Vendimi i GJEDNj për papranueshmëri i 3 qershor 2014; *Nježić dhe Štimac c. Kroacia*, Aplikacioni nr. 29823/13, Aktgjykimi i GJEDNj-së i datës 9 prillit 2015).

67. Kur obligimi i shtetit ose autoritetit përfshin një detyrim për të hetuar, kërkesa e shpejtësisë zbatohet për të gjitha fazat dhe aspektet e hetimit: nxitja e tij siç përshkruhet më sipër, sjellja e tij dhe përfundimi i tij. Kërkesa për përshpejtim është e natyrës relative: varet nga rrethanat e secilës lëndë, veçanërisht sfidat që paraqiten nga lëndë, vështirësitë për të hyrë në dëshmitarë ose për të mbledhur informacion. (Shih *S.H. k. EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lëndë nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 57.).

68. Sidoqoftë, sfidat dhe vështirësitë hetimore nuk autorizojnë shtyrjen, vonesat ose ngadalësinë e pajustificueshme në kryerjen e detyrave hetimore. Kjo është një shprehje e së drejtës më të gjerë për procedime pa vonesa të panevojshme, e cila u garantohet të gjitha palëve në procedurat gjyqësore. Shih, përsëri, *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lëndë nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 57. Paneli ka theksuar kështu që –

"E drejta për një seancë dëgjimore të drejtë dhe publike brenda një afati të arsyeshëm siç kuptohet në nenin 6(1) të Konventës është dizajnuar për të mbrojtur "të gjitha palët në procedurat gjyqësore ... kundër vonesave të tepërta procedurale ... Për më tepër, në rastet penale e drejta është e projektuar për të shmangur që një person i akuzuar të mbetet shumë gjatë në një gjendje pasigurie për fatin e tij "[...]" (Maksutaj kundër EULEX-it, 2014-18, 12 nëntor 2015, par. 57, citimet e tij janë nga Stogmuller k. Austria, Aplikacioni nr. 1602/62, aktgjykim i 10 nëntorit 1969, paragrafi 5; përsëritur në *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lëndë nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 57).

69. Një angazhim dhe lidhje e rreptë ndaj këtyre standardeve është veçanërisht i rëndësishme për një mision të sundimit të ligjit që synon të shërbejë si një shembull i angazhimit të shoqërisë për t'i dhënë fund mosndëshkimit dhe për të ndërtuar në të një ndjenjë përgjegjësie ndaj shkeljeve të rënda të të drejtave. Çdo standard që është më pak se ai që u përmend më sipër do të rrezikonte të krijonte një ndjenjë të pranimit të mosndëshkimit dhe mosrespektimit të kërkit të drejtësisë dhe llogaridhënies ndaj shkeljet serioze të të drejtave. (Shih *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lëndë nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 55.) Çdo standard i shkurtër nga ai i përmendur më lart do të rrezikonte krijimin e një ndjenje të pranimit pa u ndëshkuar dhe shpërfillje për kërkimin e një viktime për drejtësi dhe përgjegjësi (shih *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lëndë nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 55; *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, Vendimi dhe Gjetjet, 11 nëntor 2015, par. 46).

70. Duhet gjithashtu të theksohet se të drejtat që i nënshtrohen kësaj ankese janë ndër më të rëndësishmet nga të gjitha të drejtat themelore. Ata prekin interesat thelbësore të viktimave të pretenduara dhe duhet të garantohen në të gjitha rrethanat - Nenet 2 dhe 3 të Konventës janë të drejta të pazëvendësueshme (shih 2016-15 *Dragan Janačković kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, 26 mars 2021, paragrafi 37) . Praktika e zhdukjes me forcë përbën një shkelje të egër të këtyre të drejtave. Kjo pasqyrohet, ndër të tjera, në faktin se praktika e "zhdukjes me forcë" tani konsiderohet dhe karakterizohet si krim kundër njerëzimit, në veçanti, në Statutin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare (Statuti i Romës, neni 7 (1)(i)) dhe në Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji Nr. 05/L-053) (neni 13 (1)(i)). Shih gjithashtu *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lëndë nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 59

Lëndët e “zhdukjes me forcë” në kontekstin e mandatit të Misionit

71. Paneli tashmë ka përcaktuar që kjo lloj lënde që përfshin një zhdukje të detyruar, hyn brenda mandatit ekzekutiv dhe kompetencës hetimore/prokuroriale të Misionit. (Shih, p.sh., *DW, EV, FU, GT, Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, Vendimi mbi Pranueshmërinë, 30 shtator 2015; *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, Vendimi për Pranueshmëria, 29 shtator 2015; *Zlata Veselinović, HS, IR kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, Vendimi mbi pranueshmërinë, 30 shtator 2015; *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, Vendimi dhe Gjetjet, 11 nëntor 2015; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, nr. i lëndës 2016-28, 11 shtator 2019.) Misioni nuk konteston se ishte kompetent për të hetuar këtë rast. Në të vërtetë, ai ndërmori disa hapa hetues në lëndën aktuale në ushtrimin e kompetencës së tij juridiksionale.

